



**AKT - THEMELIMI**  
**Shoqerise "AK INVEST" sh.a.**

Me kete Akt Themelimi, i cili bazohet ne Ligjin Nr.7638, Date 19.11.1992, Ligjin Nr.7667, Date 28.01.1993,ne aksioneret themelues,

**Muharrem KOKONA**,biri Baftjarit dhe Silvanes,dtl.1962,lindur dhe banues ne Tirane,me adrese Rr."Nikolla Tupe",Pall. 4,ap.41,me Nr.1877813 Pashaporte si dhe,  
**Illir ADILI**,biri Sulejmanit dhe Aferdites, dtl.1961,lindur dhe banues ne Tirane, me adrese Rr."Nikolla Tupe",Pall.4,ap.40, me Nr.0573000 Pashaporte,

**Kemi vendosur :**

Te themelojme Shoqerine, sipas se drejtes shqiptare shoqeri anonime, me emertimin "Ak Invest" sh.a.

**Neni 1**  
**Themelimi**

Aksioneret themelues bien dakort te krijojne Shoqerine "Ak Invest" sh.a.,sipas legjislacionit ne fuqi ne Republiken Shqiperise.

**Neni 2**  
**Selia Administrative**

Selia administrative e Shoqerise "Ak Invest" sh.a. ndodhet ne adresen Rr."Dede Gjo Luli",Nr.2/3 Tirane. Shoqeria mund te hape filiale, dege apo zyra perfaqesimi ne qytetete te Republikes Shqiperise si dhe, jashte saj.

**Neni 3**  
**Objekti**

Shoqeria ka per objekt te veprimtarise se saj :  
**a.**te ofroje sherbimin e pagesave dhe te arketimeve,  
**b.**te ndermjetesoje per transaksionet monetare (duke perfshire valutat),

te ofroje sherbimin e kasave te sigurimit,  
te sherbeje si agjente ose keshilltare financiare (ketu nuk  
perfshihen sherbimet e parashikuara ne piken 3/a dhe 3/b te  
nenit 26) te Ligjit "Per Bankat ne Republiken e Shqiperise").

#### Neni 4 Organet e Shoqerise

- a. Asambleja Pergjithshme Aksionereve,
  - b. Keshilli Drejtues dhe,
  - c. Komiteti Kontrollit.
- Procedura e formimit dhe funksionimit te Shoqerise percaktohet  
ne Statutin e Shoqerise.

#### Neni 5 Pergjegjesia Personale

Pasuria e luajteshme dhe e paluajteshme e aksionereve te  
Shoqerise jashte aksioneve qe ata zoterojne ne kapitalin  
themelues te kesaj Shoqerie si dhe, drejtuesit, administratoret,  
punemarresit ose perfaqesuesit e Shoqerise, jane gjithmone te  
perjashtuar nga detyrimet e cdo lloji qe rendojne mbi Shoqerine.


#### Neni 6 Kapitali Shoqerise

\*Kapitali themeltar (fillestar minimal) i Shoqerise eshte  
30.000.000 (tridhjete milion) leke. Ai eshte i ndare ne 300  
(treqind) aksione te se njejtës kategori me vlere nominale te  
barabarta prej 100.000 (njqind mije) leke per cdo  
aksion. Aksionet jane te numertuara nga 1 (nje) deri 300  
(treqind), perfshi numrin e fundit te aksionit.

\*Aksioneri Ilir ADILI ka **150 aksione** te derdhura te kapitalit te  
Shoqerise, gjithashtu dhe aksioneri Muharrem KOKONA ka **150  
aksione** te derdhura te kapitalit te kesaj Shoqerie.

\*Numri minimal i aksioneve te kapitalit te Shoqerise do te  
percaktohet sipas nevojave dhe kushteve te pergjithshme, nga  
Asambleja Pergjithshme Aksionereve. Ndersa, Banka Shqiperise  
percakton ndryshimin e shumes se kapitalit minimal nga nje  
periudhe ne tjetren.

\*Pergjegjesia e aksionereve, per detyrimet e Shoqerise kufizohen  
ne vleren nominale te aksioneve te kapitalit qe ata zoterojne ne  
kete shoqeri.





**Neni 7**  
**Kohezgjatja Shoqerise**

Shoqeria "Ak Invest" sh.a. fillon aktivitetin me rregjistrim e saj ne Rregjistrin Tregtar, prane Gjykates Shkalles Pare Tirane dhe ate te Tatim-Taksave te Rrethit Tirane. Kohezgjatja e aktivitetit te saj, eshte per nje kohe te pacaktuar.

**Neni 8**  
**Te Pergjithshme**

Rregullat mbi organizimin, drejtimin apo adminsitrimin e Shoqerise si dhe ceshtje te brendshme te saj, parashikohen ne Statutin e saj bashkelidhur, i cili, sipas rastit, mund t'i nenshtrohet ndryshimeve statutore me Vendim dhe miratim te Asamblese Pergjithshme te Aksionereve. Shoqeria ka vulen e saj, me inicialet dhe emertimin qe vijon : "Ak Invest sh.a.".

Bere ne Tirane, me 2002

**AKSIONERET THEMELUES**

Z. Muharrem KOKONA

Z. Ilir ADILI